

BIBLIOTEKA


844-1

L 20

FERIT LAMAJ

BILBILI DHE GJINKALLA

- FABULA
- VJERSHA
- HUMORISTIKE
- EPIGRAME



8/11/8

120

Redaktor
SEVIM ARBANA
Piktur
BARDHYL FICO
Kopertira
JUSUF SHAHINI

Ferit Lamaj

Ky vëllim ka përmbajtje të pasur dhe interesante
Kompletuar të 45-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

BILBILI DHE GJINKALLA



- FABULA
- VJERSHA
- HUMORISTIKE
- EPIGRAME

FABULA

Redaktor
Ymer Çiraku
Gjergj Kollçi

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

NJË THËNIE E RE

Që prej shekujsh rron e thëna:
«Qengj' i urtë pi dy nëna».
Por nuk dini më të renë:
«Pi servili gjithë kopenë!»...!



SEKRETI...


Dëgjonin arinë
në pyll, në kuvend,
kafshë, shpendë ngrinë,
rrinin si mbi gjemb.

— Mjaltin sot te zgjoi
kush e hëngri, kush?
Sorkadhja, palloi
a ti, lepurush?

Ç'më rrini të ngratë?
Ç'më rrini të gjorë?
Po kur e përlatë
s'ju erdhi pak zor!?

Sekreti që heshtnin
na qenka gjetiu:
... Me miza tek veshi
është mbushur ariu...





SYRI, VESHI, HUNDA

Dhe kur sytë syze vunë,
u nxe veshi: — Hë, moj hundë,
t'u mbush mendja që s'flas kot!
Me hilë u nda kjo botë:
I mbajmë syzet unë e ti;
për të ,parë... sheh ai!...



KUNADHJA DHE THËLLËZA

*Një thëllëzë vetmitare
has kunadhen buzë një are
e në çast u drodh nga frika.*

*— Uh, të tremba, më rëntë pika!
Sa të të prek pakëz në faqe,
të të puth, moj budallaqe!*

*Dhe thëllëza, pak nga pak,
mori zemër, mori gjak:
— Sa e bukur, sa e mirë! —*

*I zgjat faqen gjithë dëshirë.
Grabitqarja nuk vonon,
bën ta puthë, e kafshon...*

DELJA DHE DASHI

Qe një dash, vriste përpjetë:
«Do të bredh ku dua vetë!»
Dhe harbonte larg nga stani.
Më në fund u nxeh çobani.

— More, unë të kam në dorë!
E i vari një këmborë.
Por s'i ulet ajo hundë,
dang e dung këmborën tund.

I thotë delja: — Mor i ngratë,
është këmborë, jo... dekoratë!



Mje vish ludi, takon d'helprën,
 — kërtoj e qoftë d'nakëri!
 Më d'cedhtra e shijm jetën,
 për këtë flet lachtesia...

— Do bëhë mirë të kyçesh gojën
 për shprehur këmbë e gjatë,
 kështu që m'ushtror Trupin
 ishte kalë, s'ishit d'helprë!

QE Ç'NA QE...

— Qe ç'na qe,
 një rrip ullastriku —
 — i tha krahut:
 — Or lum miku,
 s'ke ç'i bën,
 u nda ky fat:
 ti i shkurtër,
 unë ... i gjatë.
 Që të flasim
 porsim miq,
 ja, provo
 e më tërhiq!

E tërhoqi
rripin ky;
shkoi një metër,
shkoi dy...
I flet rripi:
— Hë të thashë!
— Prit, — tha krahu; —
prit, avash!
Dhe në çast
e la të lirë...
Mbeti rripi
si i ngrirë.
S'foli më,
se s'kish guxim.
Tani matej
... me centim...

KALI E DHELPRA

Një ditë kali takon dhelpërën:
— Rroftë e goftë dinakëria!
Me dredhira e shtyn jetën;
për këtë flet lashtësia...

— Do bësh mirë të kyçësh gojën
kur përmend kohën e vjetër;
kafsha që mashtroi Trojën
ishte kalë, s'ishte dhelpër!

— Po, vërtet ishte një kalë
që trojanët i gënjeu.
Porse ky a s'kishte dalë
nga një dhelpër, ... nga Odiseu!?



Një ditë kalli lakor dhelpërin:
— Hrojtë e gojë dimërin!
Më dërdërin e shtëm jetë;
për këtë jetë lëshësin.

— Po dësh mirë të lëshësin gojë
kurrë për mërin kohë e jetë;
kështu që mërin Trojë
është këtë, shtëm dhelpërin.

— Po, nëntë ishte mirë kalë

DORA, MASHA E THËNGJILLI

*Dora mashën zë nga veshi
E pastaj prushin përsheshi.*

*Një thëngjill nxori shkëndija:
— Ja që iku burrëria.*

*Pse fut mashën, moj e shkretë;
Po ta mbajti, më zër vetë!...*

MAJMUN KUZHINIERI

*Kur e zunë me presh në dorë
derdhi lotë plot një orë.*

*— E pranoj, — tha — në kuzhinë
e kam shkëlur cilësinë.*

*Se dhe supën e kam shtuar
plot me ujë, por kam gabuar.*

*Këta lotë me dënesë,
ju, si thoni, s'janë pendesë?*

*— Të besojmë, s'qan kot fare:
Ja, ke qepën dëshmitare...*



DY GRINDAVECET

- Si s'ke turp që bën rrëmuje,
kur s'më mban një pikë ujë!
— Ç'thua, moj, turp të kesh vetë!
Dhe shamata bën përjetë...

Po kush grindet pra, kështu?
mund të pyesë ndonjë nga ju.
Sherrin që vijon çdo ditë
e bëjnë... shosha dhe një sitë!...

GOMARI DHE I ZOTI

Një gomar kish vërë dylbinë,
shitejta për në laginë.
— Gërka e përta — thash
— veshjtari —
s'leto më syri, kad e pati!

Tha i zoti: — Ç'lehtësim
pë po për gomari tani!
O' luptohet, të vjetër t'u
Pse dylbinë e vë në sy —
e mën përse pastaj dësh:
— P' proro e shpirt me... veshjtari...

DAULLJA DHE SHKOPI

Kur daullja zhurmën nisi,
s'duroi shkopi, qesëndisi:
— Ee, çudi, vërtet çudi;
unë punoj e... gjëmon ti!



GOMARI DHE I ZOTI

Një gomar kish vënë dylbinë,
shihte larg, gjer në luginë.

— Qenka ç'qenka, — thosh
veshgjati, —
s'vlen më syri, kaq e pati!

Tha i zoti: — Ç'vlerësim
që po jep gomari im!

Or llapush, të pyes ty:
Pse dylbinë e vë në sy? —
e nën buzë pastaj qesh:

— Pa provo e shih me... veshë!...



KUZHINIERI DHE MAÇOKU

Kishatë dhe në krahinë
mucë dhe s'prijnë mënj.

U bë pas, se te një kënd
mbetura këtu këtu.

Kuzhinieri mërr inat!
— Do zësh mirë a të t'prijnë!

ÇARKU DHE MIU

Ra në çark një natë miu.

Obobo, bobo, ç'e piu!

Çarku derën fort kërciti
dhe hajdutit seç ia priti:

— Më në fund, o mi, të kapa.

Kot mos shih sa para prapa!

U zgjat miu, u hollua,
pastaj doli: — O çark, mua
ti më zë, por dal sërish.
Të ha bukë, djathë, mish...

Çarku foli gjithë inat:

— Ke të drejtë, je me fat!

Edhe shtoi paskëtaj:

— Cilësia më ka faj.

Pasi telat, more mik,

i kam... bakër, jo çelik!

KUZHINIERI DHE MAÇOKU

Kishte ditë që në kuzhinë
maçi hiç s'gjuante minj.

E di pse, se te një kënd
mbeturina kish një dëng.

Kuzhinieri merr inat:

— Do zësh minj a të t'naxjerr
jashtë!

Unë kurrkënd më kot nuk mbaj.
I tha macja: — Vetë ke faj!

Ç'të zërë minj, o kuzhinier,
kur te dëngu lëvin... gjellë...



DRERI DHE SËPATA

Në pyllin e gjerë
ç'na ndodhi njëherë:
Dreri pa sëpatën,
iku, mori datën.
Një pemë i thërret:
— Ku ikën shigjetë?
Ti ç'pate, vëlla,
s'je lis, as ah!

Por dreri na foli
vetëm kur doli
përtej te një breg.
— Nuk është çudi,
t'i duken si degë
këta brirët e mi!...



Në pallat e gjera
 e në moshë të rënda;
 Dreq për shpatë,
 dhe për durrësi,
 Në qendër të fëmijëve;
 — Këtu këtu shpirtet
 Të gjalla, të gjalla,
 të gjalla, të gjalla.

Por tani tani
 vërtet tani
 për të tani
 — Në këtë kohë
 të duket si
 këmbë

DORA DHE KËMBA

Qahej dëra: — Ç'm'u desh mua,
 të bëj nder e të jap hua!
 Po ti, këmbë, ç'më rri, ç'pret;
 mos pandeh se të vjen vetë!

Ia kthen këmba: — Dreq o punë,
 ti e jep, e... ta marr unë!

FLUGERI DHE SELIMI

*Kur Selimi pa flugerin,
o sa fort e ngriti zërin:*

— Ç'e ka mirë, se ngahera
dridhet nga të fryjë era...



BUFI NË KUVEND

Fliste bufi në kuvend:

— Pa dëgjoni, zogj e shpendë,
ç'është kjo nofkë «vjedhacak»,
kur unë ditën s'dal aspak!

*Zogj e shpendë pëshpërinë...
Më pas flet një kanarinë:*

— Ashtu është, sikur thatë,
porse... vjedh kur bëhet natë.



CADRA, KOSTUMI DHE NJERIU
TE KOTECI NE MENGJES

Te koteci me manges
gjatqis golltate veze.
Kur e shene, n' hode p'pjeten.
— Jo, jo, jo, jo, kam q'ne q' veze!
Qe te bidein me tamm,
me q'et q'umet, kur i kam,

MERIMANGA, MIZA DHE FLUTURA

I the q'et: — Natyralit,
si t'izur i fshim... me dish!

Merimanga lart, në mur
diç po end, diç po thur.

U hodh miza gjithë gëzim:
— Bah ç'motive, bah ç'qilim!

Tha një flutur: — Moj e shkretë,
s'është qilim... por është rrjetë...

TE KOTECI NË MËNGJES

Te koteci në mëngjes
gjarpri gëlltiste vezë.

Kur e zunë, u hodh përperjetë:

— Jo, jo, jo, s'kam ngrënë gjë vetë!
Që të bindem me tamam,
më gjej gjurmët, ku i kam?

I tha gjeli: — Natyrisht,
si tinzar i fshin... me bisht!



ÇADRA, KOSTUMI DHE NJERIU

I thosh çadrës një kostum:

— *Moj, po ti, si s'bën një punë!*

*Më rri varur, ke një muaj;
parazite po të quaj.*

*Rri dhe unë në kremastar,
por veç pak, se udhët marr.*

— *Or kostum, — ndërhy njeriu,
sa vlen çadra, e di... shiu!*



EDHE UNË NË...AKSION

Varg makinat që me natë
nga qyteti për në fshat
U poq gruri, po verdhon,
shpejt ta korrим me aksion!

Por nga fshati një fshatar
me dy kosha mbi gomar
një me presh, tjetrin me qepë
mori rrugën për qytet

Një makinë te një kthesë
hasi veshon nën ngarkesë.

Ty-ty-ty i ra borisë:

— O i zoti i shtëpisë,
që pa gdhirë për ku shkon!?

— Edhe unë në ... aksion...



SYRI DHE GJUHA

*Qe një gjuhë, gjuhë lopatë,
nuk pushonte ditë, as natë.
I thotë syrit: — Ti je kot,
vërtet sheh, por... a flet dot*

*Ia kthen syri: — Qysh s'e di,
shpesh unë flas më mirë nga ti!...*

DARDHA E LOFATA

Lart në kodër një lofatë
mburrej ditë, mburrej natë:
— Ç'janë ato lule të bardha,
që mban kumbulla e dardha!?
Dhe pa ngjyrë, dhe pa jetë,
lule po, lule kam vetë!

Ia kthen dardha: — Zërin ule,
ty të rrofshin ato lule!
... Pasi kokrrat, si ngahera,
i mbajmë ne, pemët e tjera...

DHOGA DHE TURJELA

Një turjele i thotë dhoga:
— *Moj, po ty s'të merr vesh koka!?*
Ç'më përdridhesh, moj e shkretë,
s'je në shfaqje në balet,
Unë s'pyes për njeri;
daç të vijnë njëqind si ti!

Por turjela qetë-qetë
shpo një vrimë, pesë, dhjetë...
Dhoga heshti këtë herë,
s'foli më llafe në erë.

E ç'të fliste!... Ajo tash
ishte kthyer në tallash...

ORA DHE DORA

Orëndreqësit një ditë
 i flet ora: — Prit, o prit,
 ti më ndreq, është e vërtetë,
 por pastaj unë punoj vetë.
 S'më ke parë, për merak,
 kur trokas «tik-tak, tik-tak...»

Tha ustai: — Ç'përrallis!
 A e di kush të kurdis?...

Kur takoi Punën Frikë,
i the lëja: — Eh, moj mik,
ti rretel mban emrin punë,
porë... lëja je si mik!

IRIQI DHE ZOGA

— Oh, sa mirë, — tha një iriq, —
sikur ne të ishim miq!

Pa do rrinim bashkë nën vesë;
unë pëllumb, ti pëllumbeshë!

Përse trembesh, ç'është kjo frikë?

U hodh zogja: — Eh, or mik,
a e di përse u tremba:

... S'kam dëshirë të rri në gjemba!



MIKROFABUL

*Kur takoi Punën Fizike,
i tha Leja: — Eh, moj mike,
ti vërtet mban emrin punë,
porse... leje je si unë!...*



Kur pa maci... vetëtimë
një mish u jshëm në vrimë.
«Mjam, mjam» bot e bot
mjoullante maci kot.
Prit, e prit, e prit në dritë.
Miu «bëhej» hiç i gjallë.

Më pas maci thur një plan
në të bëjë: «Ham, ham, ham»
Tha mishat: — «E, ky qet
zagonjë dhelpër po ndërron!
Njeri ka qepë tërë ditë»

ULLIRI DHE PURTEKA UXRUKU

— Nuk më rrihet pa ta thënë
një vërejtje, një të metë.
Ti, ulli, ngarkohesh rëndë,
por... një herë në dy-tre vjet!

! Dhe ulliri ia pret shtruar: —
— Se më dole vetë në shteg:
nëse s'jam çdo vit ngarkuar,
! ke dhe ti faj, moj purtekë!

SFURKU E KREHËRI

*E di ç'ngjau te një arë?
Krehëri po mblidhte bar.
Mblidh e mblidh, bëri një tog...
E sheh sfurku e i thotë:*

*— Eh, o krehër, kështu mbete!
Si gjithnjë, tërheq për vete.
Nguli dhëmbët, barin mori:
— Nuk e sheh, po pret zetori!*

MË NDIHMOI GJUHË E HUAJ

Kur pa maçin... vetëtimë
një miush u fsheh në vrimë.
«Mjau, mjau» bot e bot
mjauillinte maçi kot.
Prit, e prit, e prit të dalë.
Miu s'bëhej hiç i gjallë.

Më pas maçi thur një plan:
nis të bëjë: «Ham, ham, ham!»
Tha miushi: — Eh, ky qen
ndonjë dhelpër po ndërren!
Nxori kokën për të parë,
por aty maçi kusar
shpejt e kapi: — Hiç mos luaj!
Më ndihmoi gjuhë e huaj...



BILBILI DHE GJINKALLA

*Dhe gjinkalla ia kish marrë
melodisë shtruar-shtruar...
Tha bilbili këngëtar:
— Të zë halli, do dëgjuar!*

*Në fund zogu, për çudi,
përplas krahët papushim.
Tha gjinkalla: — Mund ta di,
të pëlqeu zëri im?*

*Dhe bilbili tha dy fjalë:
— Përplas krahët me sa mund,
jo për këngën, moj gjinkallë,
por... shyqyr që i dhe fund!...*


IRIQI DHE MIU

Një ditë më të gdhirë
iriqin pa një mi:

—Popo, ç'gjë e pështirë,
s'u shikka dot me sy!

— Është kush është i pështirë, —
iriqi gjëmbat çon, —
a s'do të ish më mirë
të tjerët le ta thonë!? —
Dhe shtoi me finesë:

— S'i ke në rregull trutë,
ndërsa unë rroj në vesë,
ti rron, o mi, në ...



SEMAFORI DHE KAMIONI —

Një kamion në kryqëzim
s'ndali, iku fluturim...
Semafori tha: — Kamion,
ti shikon a nuk shikon?
Ç'e ke drejtin këtë huq;
s'ta mbush synë sinjal' i kuq?
E ke hak fjalën e keqe,
se nuk paske hiç ndërgjegje!
Përfiton, ore lum miku,
ngaqë s'ka polic trafiku.

Tha kamioni: — More mik,
ty të lumtë që bën kritikë.
Por... ç'faj paskam unë i mjeri,
në timon drejton shoferi!

KARRIERTI DHE ASHENSORI

DHELPA DHE QENI

Hajdutja dhelpër u nis me natë:

— Në mos një pulë, do të vjedh patë!
Iu gas kotecit...

S'kish bërë një hap,
kur qeni rojë iu hodh, e kap.

— O qen, o mik, unë këtë herë
s'erdha për pula, jo, jo, për nder! —
Edhe dinakja vijon dredhinë:

— Ju bëra provë... gatishmërinë!



BULKTHI E KAPOSHI

*Bulkthi, thonë, një mëngjes
bënte fjalë me një këndes:*


*— Përse thoni se bëj zhurmë?
Më të heshtur ka se unë!
Më të urtë ka në botë!
Ndaj ankimi është i kotë.*

*Shpejt kaposhi trupin shkund
e t'i kthehet më në fund:*

*— Po, e dimë, ditën s'flet,
bulkth, je urtësia vetë.
Porse natën, more lumë,
mjerë ne ç'heqim për gjumë!...*


KARRIERISTI DHE ASHENSORI

*Kjo është shpikja më e rrallë,
s'do të ngjitem më me shkallë.
Mirë, o mirë që shkon përpjetë,
porse ka dhe një të metë.
Eh, ç'e do që ulet prapë;
ja, këtu të drejtë s'i jap!...*



Kjo është shprehja e tërës
e do të njihim me të shkollë.
Më, e më të shkollë për të
përse ka dhe një të mëtej.
E, e do të shkollë për të
e, e do të shkollë për të.

KETRI NË ZABEL



Dhe ketri në zabel
lexonte një tabelë
te trangu i një qarri:
«Mbroni pyjet nga zjarri!»
— Po kjo, — ketri thotë. —
sikur s'është e plotë. —
E shtoi me shkronja të arta:
«Nga zjarri dhe nga... sëpata!»

GJELI E MJELMA

Hidhej gjeli tej, në fushë:

— Këngëtar më njeh gjithkush!

Sot e tutje, e di vetë,
do të njihem si poet! —

Dhe kokoshi merr e jep,
prish e ndreq vargje me sqep.

Mbush me vargje një fletore,
shkon te mjellma redaktore:

— Jepmë, mike, një mendim,
sa e çmon këtë vëllim?

Mjellma s'di të mbajë hatër:

— Ja, e pashë vëllimin tënd.

Gjelkokosh, ke notën katër.


Jo me sqep, shkruaj me... pendë!



GOMARI I KOOPERATIVËS

Ç'i tha mushka një gomari:
— Pse kujdes s'të ka Baftjari?
Për çdo ditë ti ha dush,
se yt zot di vetëm «Ush!»
Edhe ujë më të rrallë,
sa mezi mban shpirtin gjallë!

— A e di pse ngjet kështu,
që përditë unë ha dru!?
Fjala gjetkë mos na dalë:
... Nuk më ka mall personal!...



MENDJA, SYRI, HUNDA

*Ish një sy, një sy, për dreq,
që kish marrë huq të keq:
s'shihte fare aty pranë,
por matanë, tejmatanë.*

*I tha mendja: — More sy,
bëj çudi, çudi me ty.
Shih më parë ç'ke përqark,
më pastaj bridh tutje, larg. —
E një thumb i ngjesh në fund:
— Ngjitur ti ke motrën hundë!...*

KOPRACI POROSIT GRUAN

*Gjilpërën që more hua
dje te fqinja, o moj grua,
kur t'ia kthesh, hapi sytë mirë:
... Mos harron perin në birë!*



LULJA E DIELLIT DHE SHOKU LIKE

Shëët, mos prishni qetësinë!
Shqetësohet shoku Like!
Ka dy vjet në tavolinë,
po bën shkencë agroteknike.

Dhe ta dini, shkencë e tillë
që prej shekujsh s'është parë!
Mbill e korr, e korr e mbill,
veç... në zyrë, jo në arë,

Seç u nxinë dhjetra fletë,
ja, e sosi dhe studimin.
Gra e burra në arë shpejt,
do të bëjmë përrurimin!

U habit kushdo që qe
rreth e qark asaj parcele:
... Lule dielli prisnim ne,
na dhuroi... «lule dele»...





SULA MOT DEL NË PENSION

Që kur shkeli në repart,
Sula erdhi i paastë.
S'prishi qejfin asnjë çikë,
kish mburojë shokun Tefik.
«Sot për sot vërtet nuk di,
do mësojë, — thosh, — është i ri».
Shkon një vit e vjen një tjetër,
nga «i ri» u bë «i vjetër»,
mirëpo mbet ai i pari,
s'di se nga lidhet gomari.
«Mos u ngutni, pak durim;
vetë jeta është mësim» —
kështu thosh shoku Tefik
edhe mosha ik e ik...
Do mësojë... (po kur më vonë?)
Sula mot del në pension.



MENDJEMADHI E LLAFAZANI

— Hajde, hajde, ç'llafazan;
po mjaft llape, mor aman!
Në fytyrë s'ke gjë tjetër,
vetëm... gjuhë, gjuhë, o Pjetër!

Ia kthen Pjetri më në fund:
— Ndërsa ti ke vetëm... hundë!



NDOSHTA...

Një kryetari kooperativ

Pse nuk mbin gruri te ara?
... Duhet parë disa faktorë:
Ndoshta ish e dobët fara,
ja pra, kemi një në dorë.

Ndoshta shiu që s'ra kurrë,
dy në dorë dhe pa frikë;
ne do kishim goxha grurë,
jo kështu, si shtatanik!


Ndoshta, ndoshta, gjithnjë flet.
Bjeri drejt, o kryetar.
Ju, or ju, keni faj vetë?
Ndoshta... kjo pra, duhet parë!



ME NJË KONFUZ

— Keni parë njeri si unë?
Nis njëherësh dhjetë punë...

— Po, vërtet, — ia pret një zë, —
veç... nga dhjetë, nuk sos asnjë...



PIJANIKU KËRKON PUNË

*Prush e flakë në fytyrë
shkon te shoqja Netë, në zyrë:
— A e di pse erdha unë?
Nëm një fletë, fletë për punë.
Ku do hyj, ti do të dish!?
... Në punishten e rakisë.*



LLAFAZANI

*Për herë të parë, në agoni
nisi të bëjë autokritikë:*

*— Kam folur shumë, o miq, e di!
Por ja, që sot them t'i vë pikë.*

*E mbajti fjalën.
Tash që s'është gjallë,
... s'e nxjerr nga goja
as dhe një fjalë...*

DIALOG

— Hello, Xhimi, bëj çudi,
u fejove përsëri!?

A i the, more vëlla,
që ke ndarë plot tri gra?

— Po, i thashë, veç s'kish vlerë,
qe ndarë vetë katër herë...



NJË TË PAFYTYRI

Të takova në dyqan
 teksa bleje një pasqyrë.
 E ç'e do, o mik e xhan,
 ç'do shikosh, kur s'ke... fytyrë!?




NJË TË PAAFTI

«I paaftë» kot të thonë!
Jo, kjo nofkë s'të takon.
Gjersa merr paratë e rri,
më të aftë a ka se ti!?



MUE TE PAARII

«I paarlës» Kështu thotë
Jo, kështu thotë së talon.
Qjersa në rrugë e t'at
në të njëjtë a ka se t'at



OPORTUNISTIT

*Ul e ngri
njëqind flamurë.
Si s't'u loah
dora, mor burrë!*

GËNJËSHITARË

*Një gënjeshtër më the mbrëmë...
Unë e mora si të qënë.*

*Të besova sot sërish,
edhe pse gënjeshtër ish.*


*... Nesër nëse nis e flet,
goftë kjo dhe e vërtetë,
mos u lodh më kot, or burrë,
se nuk të besoj më kurrë!*

TIRATHSHEMBE

NJË KOPRAC

*Nusen time do ta gjej
me çdo kusht afër shtëpisë.
Se... kështu do të kursej
edhe lekët e taksisë!*

TRATIMET E
EPITAFI SERVILI
Kur i jepin një cigare
e rrëmben (është pa pare).
Shpejt harron, dje ç'na ka thënë:
«Prej një viti e kam lënë!»
E ka lënë, po vërtet:
s'pi më nga paket' e vet...



QYLAXHIU

*Kur i japin një cigare
e rrëmben (është pa pare).
Shpejt harron, dje ç'na ka thënë:
«Prej një viti e kam lënë!»
E ka lënë, po vërtet:
s'pi më nga paket' e vet...*

EPITAF SERVILIT

*Trupin e drejtoi veç një herë
i ndjeri Kolë:
ditën që u shtri sa gjatë-gjerë
në arkivol...*



NJË SHKRIMTARI

*Kur hyn viti, vë në plan:
«Do qëndis goxha roman!».
Ikin muajt, s'po të del
jo roman, por as novelë!
U mbyll viti, miku im,
bëj të paktën një... tregim!*



EPIGRAME PËR VITIN E RI


PREPOTENTI

*Vit i Ri,
Vit i Ri:
... O unë,
o ti!*



LIBERALI

Unë s'jam si ca të tjerë
që tre kyçe vënë në derë.
Tek unë hyn pa shumë siklet.
Eja, daç dhe... më tridhjetë!...



LIBERALI

DEM BELI

Vit i Ri, të pres i qetë;
bujrëm, gjer në orën tetë!
Gjer më tetë, jo më shumë,
se pas tetës ia fus gjumë...



SIMULANTI

*Vitit të Ri
s'i kërkoi shumë i ngrati:
...Gjashtë muaj
regjim shtrati...*



SIMULANTI

LIBRARI

Vite to fit
it's a book about the
... (faded text) ...
... (faded text) ...
... (faded text) ...



PËRMBAJTJA

FABULA

Një thënie e re	5
Sekreti	6
Syri, veshi, hunda	8
Kunadhja dhe thëllëza	9
Delja dhe dashi	10
Qe ç'na qe	11
Kali dhe dhelpra	13
Dora, masha e thëngjilli	14
Majmun kuzhinieri	15
Dy grindavecët	16
Daullja dhe shkopi	17
Gomari dhe i zoti	18
Çarku dhe miu	19
Kuzhinieri dhe maçoku	20
Dreri dhe sëpata	21
Dora dhe këmba	22
Flugeri dhe Selimi	23
Bufi në kuvend	24
Merimanga, miza dhe flutura	25
Te koteci në mëngjes	26
Çadra, kostumi dhe njeriu	27

Edhe unë në aksion	28
Syri dhe gjuha	29
Dardha dhe lofata	30
Dhoga dhe turjela	31
Ora dhe dora	32
Iriqi dhe zoga	33
Mikrofabul	34
Ulliri dhe purteka	35
Sfurku e krehëri	36
Më ndihmoi gjuhë e huaj	37
Bilbili dhe gjinkalla	38
Iriqi dhe miu	39
Semafori dhe kamioni	40
Dhelpra dhe geni	41
Bulkthi e kaposhi	42
Karrieristi dhe ashensori	43
Ketri në zabel	44
Dy çelësat	45
Gjeli e mjellma	46
Gomari i kooperativës	47
Mendja, syri, hunda	48
VJERSHA HUMORISTIKE DHE EPIGRAME	
Kopraci porosit gruan	51
Lulja e diellit dhe shoku Like	52
Sula mot del në pension	54
Mëndjemadhi e llafazani	56
Ndoshta	57
Me një konfuz	58
Pijaniku kërkon punë	59
Llafazani	60
Dialog	61

Një të pafytyri	62
Një të paafiti	63
Oportunistit	64
Gënjeshhtarit	65
Një koprac	66
Qylaxhiu	67
Epitaf servilit	68
Një shkrintari	69
Një përkthyesi	70
Një piktori	71
Prepotenti	72
Liberali	73
Dembeli	74
Simulanti	75

L. Janaj, Feriz
 Një të pafytyri dhe gjakallësi: Fabrika Vjeter
 humanitare. Feriz Janaj
 Red.: S. Arbana; Ilir B. B. B.
 T. Kaim Feriz; 1990 - 80 p.
 me il. 18 cm
 801.983-191
 801.983-7
 L. 30

Tiraži 2500 kopje. Fondi 49x78x102cm 2304-81
 KOMBINATI POLIGRAFIK - Shkup
 Be. Titov 1990